



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI REGULLATOR I ENERGIJSE

Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve

Nr. ____ Prot

Tiranë, më 14.02.2022

Lënda: Njoftim për pjesëmarrësit në tregun e energjisë lidhur me regjistrimin në kuadër të zbatimit të rregullores “Për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë” (REMIT).

Në mbështetje të nenit 16, 19, 20, gërmat “ç” dhe “d”, nenit 22, 51, pika 2, gërma “dh” dhe 97, pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 4, gërmat “a”, “b”, “c” “ç”, dhe pikat 5 dhe 6, të Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 28, pika 1, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 126, datë 17.05.2021, miratoi Rregulloren Për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT).

Kjo Rregullore në Kreun III, neni 7 përcakton detyrimin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë për tu regjistruar pranë ERE-s.

Për këtë qëllim ERE në faqen web respektivisht në Seksionin “TREGU I ENERGIJSE”, ka krijuar rubriken REMIT, në të cilën janë publikuar formularët e regjistrimit dhe cdo dokumentacion tjetër i Rregullores REMIT.

Pjesëmarrësit e tregut të energjisë të marrin masa për plotësimin e formularit të regjistrimit të publikuar në rubriken REMIT dhe të dergojnë këtë formular në ERE brenda datës 28.02.2022.

Linku i rubrikes REMIT në faqen web të ERE.

<https://www.ere.gov.al/sq/tregu-i-energjiere/remit>

KRYETARI

Petrit AHMETI